



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Podujevës**  
**Opština Podujeva / Municipality of Podujeva**



**DREJTORIA E PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

Bazuar në nenin 62.3shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 17.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 64.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, bënë këtë:

**NJOFTIM PUBLIK**

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve lokale që të bëjnë propozimet e anëtarëve të tyre për plotësimin e përbërjes së Komisioneve që do të ngritën në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe atë;

***Komisioni ad-hoc vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për njësit kadastrale në vijim:***

- **Njësia kadastrale P-00594-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **25397 m<sup>2</sup>** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore
- **Njësia kadastrale P-00596-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **16214 m<sup>2</sup>** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore
- **Njësia kadastrale P-00597-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **768 m<sup>2</sup>** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Livadh i Klasës 4 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

Në kuadër të Komisioneve në fjalë do të përfshihet nga një anëtar i sektorit jo qeveritar lokal.

Personat e nominuar për Komisionet e cekura, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV e tyre si dhe një Letër Interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këto Komisione, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet me votim në Kuvendin e Komunës.

Afati për aplikim është nga data **21.03.2024 deri më 28.03.2024**, brenda orarit zyrtar të punës, dhe të njëjtat bëhen përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Propozimet gjithashtu mund të dërgohen edhe përmes postës elektronike zyrtare, në emailin; [dkpgj.podujeva@rks-gov.net](mailto:dkpgj.podujeva@rks-gov.net)

**Nr.Pro: 08-020/04-0019079/24**

**Datë 21.03.2024**

**Udhëheqëse e Sektorit të Pronës**  
**Ardiana Dibrani**

